

Vendim nr. 200 datë 05.10.2023

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sonila Bejtja, anëtarë, në datën 05.10.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (I) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:

IZMIR HEBOVIJA

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-519 (98), datë 28.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 17, 18, pika 1, 38, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 20.08.2022 kërkuesi Izmir Hebovija (*kërkuesi*) është arrestuar në flagrancë nga shërbimet e Policisë së Shtetit, në afërsi të qytetit të Lezhës, ndërsa me një automjet po transportonte një lëndë të dyshuar si narkotike, e llojit *cannabis sativa*, e ndarë në 84 pako, në sasinë prej 10,750 kilogramësh. Krahas kërkuesit janë arrestuar në flagrancë edhe dy shtetas të tjerë. Oficeri i policisë gjyqësore ka referuar materialin kallëzues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Kjo e fundit, në datën 21.08.2022, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283, paragrafi 2, i Kodit Penal, duke regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale dhe emrat e tre të arrestuarve në flagrancë, përfshirë edhe atë të kërkuesit. Në kuadër të këtij procedimi penal, në datën 22.08.2022, prokurori i çështjes i ka kërkuar gjykatës së shkallës së parë vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” për personat nën hetim, ndër ata edhe kërkuesi.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 325 (53-2022-1852), datë 23.08.2022, për sa i përket kërkuesit, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Ky vendim, pas ankimit nga kërkuesi, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 230, datë 03.10.2022, ndaj të cilit kërkuesi nuk rezulton të ketë paraqitur rekurs.

3. Në datën 11.11.2022 kërkuesi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, me një masë sigurimi tjetër më të lehtë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 436, datë 17.11.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 298, datë 19.12.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 436, datë 17.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke zëvendësuar masën e sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit me “Arresti në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i *KPP*-së. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs prokurori, ndërsa kërkuesi ka paraqitur kundërrkurs.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-519 (98), datë 28.03.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 298, datë 19.12.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 436, datë 17.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

6. Në datën 10.07.2023 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-519 (98), datë 28.03.2023 të

Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës, në datën 11.09.2023, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuessit

7. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

- 7.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vepruar në tejkalim të kompetencave të caktuara nga neni 434 i KPP-së. Organi i akuzës ka bërë rekurs bazuar në nenin 432/a të KPP-së, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit bazuar në nenin 432/b të KPP-së, tej shkaqeve të rekursit.
- 7.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar se cili nga pretendimet konkrete të organit të akuzës të ngritura në rekurs nuk është marrë në konsideratë nga gjykata e apelit. Gjithashtu, nuk është arsyetuar asnjë nga shkaqet e kundërrekursit.
- 7.3. *Parimit të pavarësisë së brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale dhe parimit të sigurisë juridike*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar kërkimin e organit të akuzës në rekurs për ndryshimin e vendimit, ndonëse shkak i rekursit nuk mbështetet me shkakun ligjor, për të cilin vetë Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit. Në këtë rast, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur tej shkaqeve të ngritura në rekurs.
- 7.4. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur më parë nga ajo gjykatë për çështje të ngjashme.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuessit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje

Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në rastin konkret, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, detyrimi për shterimin e tyre, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, është trajtuar nga Gjykata si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur procesin, ashtu edhe të atyre të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Lidhur me këto të fundit, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 19, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procedurat gjyqësore për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, të cilat kanë përfunduar me vendimin nr. 00-2023-519 (98), datë 28.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese që pretendon se i janë shkelur në këto procedura gjyqësore.

12. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit gjyqësor që ka vendosur për çështjen e tij është i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i datës 28.03.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 10.07.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

13. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar se është cenuar parimi i barazisë përpara ligjit, për shkak të qëndrimit të ndryshëm të mbajtur nga Gjykata e Lartë për çështje të ngjashme, duke iu referuar vendimit nr. 00-2021-960, datë 16.12.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

14. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme (*shih vendimin nr. 47, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuadër, Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti. Në çështjen konkrete, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuesi, në thelb, e ka lidhur pretendimin e tij për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit me mënyrën e zbatimit të ligjit dhe interpretimit të dispozitave procedurale penale të zbatueshme në çështjen e tij, duke mos arritur të provojë në nivel kushtetues cenimin e ardhur në të drejtat ose liritë e tij për shkak të mënyrës se si ka vepruar Gjykata e Lartë në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit. Për rrjedhojë, vetëm fakti që në rastin e kërkuesit Kolegji Penal mund të ketë të arritur në një përfundim të ndryshëm nga ai i arritur në një çështje tjetër, nuk përbën *a priori* cenim të parimit të barazisë përpara ligjit dhe nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues.

15. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, që kanë të bëjnë me cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, parimit të pavarësisë së brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale dhe parimit të sigurisë juridike, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi, në thelb, i ka bazuar këto pretendime në argumentet se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur tej shkaqeve të ngritura në rekurs, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson t'i shqyrtojë në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, i cili ndikon në lirinë personale, duke mbajtur në konsideratë se kjo e fundit përbën të drejtë substanciale që nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me lirinë personale

16. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vepruar në tejkallim të kompetencave të caktuara nga neni 434 i KPP-së. Sipas tij, organi i akuzës ka bërë rekurs bazuar në nenin 432/a të KPP-së, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e gjykatës së apelit bazuar në nenin 432/b të KPP-së, tej shkaqeve të rekursit. Gjithashtu, sipas kërkuesit, nuk është arsyetuar asnjë nga shkaqet e kundërrekursit.

17. E drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se ky detyrim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*);).

18. Lidhur me çështjen në shqyrtim, referuar materialeve të dosjes gjyqësore të tërhequr për nevoja të këtij gjykimi, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se në rastin e caktimit të masës së sigurimit, në zbatim të neneve 244 e vijues të KPP-së, në kundërshtimet e tij ndaj masës “Arresti në burg” të kërkuar nga prokurori, ndër të tjera, kërkuesi ka pretenduar edhe për papërshtatshmërinë e saj nisur nga gjendja e tij jo e mirë shëndetësore, gjendje kjo që sipas tij mund të agravohej në kushtet e qëndrimit në paraburgim dhe pamundësisë së kurimit të tij në ambientet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Lezhë (*IEVP*). Për këtë pretendim kërkuesi ka paraqitur si provë kartelën klinike të lëshuar nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, sipas së cilës ai ka qëndruar i shtruar në spital për periudhën 20.07.2022 - 26.07.2022, duke evidentuar diagnozën në hyrje dhe në dalje nga spitali. Pretendimi i kërkuesit nuk është pranuar nga gjykata e shkallës së parë, me arsyetimin se referuar kartelës klinike nuk rezultonte që ai të vuante aktualisht nga ndonjë sëmundje, e cila të bënte të pamundur qëndrimin e tij nën masën e sigurimit “Arresti në burg” (*shih faqen 19 të vendimit nr. 325 (53-2022-1852), datë 23.8.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë*). Pretendimi për gjendjen jo të mirë shëndetësore është ngritur nga kërkuesi edhe në ankimin e paraqitur ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që caktoi ndaj tij masën e sigurimit “Arresti në burg”. Edhe gjykata e apelit e gjeti të pabazuar këtë pretendim me të njëjtin arsyetim, si dhe gjykata e shkallës së parë (*shih faqen 21 të vendimit nr. 230, datë 03.10.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër*).

19. Po sipas materialeve të dosjes gjyqësore, pas 5 javësh nga përfundimi i procesit të caktimit të masës së sigurimit, bazuar në nenin 260, pika 2, të KPP-së, kërkuesi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me një kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” me një masë tjetër më të lehtë. Këtë kërkesë ai e ka mbështetur mbi shkakun e zbutjes së nevojave të sigurimit si pasojë e rëndimit të gjendjes së tij shëndetësore në kushtet e qëndrimit në

paraburgim. Për vërtetimin e këtij pretendimi, mbrojtja e kërkuesit ka paraqitur shkresën nr. 9596 prot., datë 24.10.2023, lëshuar nga përgjegjësi i shërbimit shëndetësor të IEVP-së, Lezhë, ku kërkuesi ndodhej në paraburgim. Sipas kësaj shkrese, në përgjigje të kërkesës për informacion, për kërkuesin është plotësuar kartela klinike në momentin e ardhjes në IEVP-në, Lezhë, ku nga anamneza e marrë atij, si dhe një epikrizë e daljes nga spitali, rezultonte se ka qëndruar i shtruar në spital për periudhën 20.07.2022 - 26.07.2022, me diagnozë në shtrim “hemorragji gastrointestinale” dhe me diagnozë në dalje “status post hemorragji gastrointestinale, ulkus bulbi duodeni aktive post hemorragjike”. Gjatë qëndrimit në paraburgim ai është trajtuar me mjekim dhe ka arritur të krijojë stabilitet klinik, pavarësisht se nga analizat e datës 19.10.2022 ka oshilacione të formulës leukocitare me ulje të theksuar të elementeve (qelizave) figurante të gjakut. Ai vazhdon të jetë i rrezikuar nga shfaqja e hemorragjisë gastrointestinale, meqenëse ulcera nuk ka bërë ende shërim të plotë. Po kështu, mbrojtja e kërkuesit ka paraqitur si provë edhe shkresën nr. 9596/1 prot., datë 28.10.2023, lëshuar nga i njëjti autoritet shëndetësor, ku si informacion shtesë jepet kryerja e rikontrollit të planifikuar të kërkuesit në datën 25.10.2022 dhe rezultatet e ekzaminimit (fibrioskopik) e konkluzionet e nxjerra në këtë rast, konkretisht “ulcer bulbi në cikatrizim” dhe “stenoze parciale apikale (bulbar)”. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e saj, pasi ka arritur në përfundimin se nevojat e sigurimit nuk kanë ndryshuar në raport me ato në momentin e caktimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit. Ajo ka arsyetuar se nga provat e paraqitura nuk evidentohet se gjendja shëndetësore e kërkuesit është e tillë që bën të pamundur qëndrimin e tij në paraburgim, përkundrazi, gjatë këtij qëndrimi, kërkuesi është mjekuar dhe ka kryer ekzaminimet e nevojshme mjekësore, duke mos qenë kështu para përkeqësimit të gjendjes së tij shëndetësore për shkak të qëndrimit në paraburgim (*shih faqet 7-8 të vendimit nr. 436, datë 17.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë*).

20. Bazuar në ankimin e kërkuesit, gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke zëvendësuar masën e sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit me “Arresti në shtëpi”. Gjykata e apelit ka arsyetuar se nga provat e paraqitura provohet se gjendja shëndetësore e kërkuesit është rënduar, pasi ai vuan nga ulcera e stomakut, që i ka dhënë gjakderdhje të brendshme (melenë), duke pësuar anemi akute. Sipas provave, kërkuesi vazhdon të jetë i rrezikuar nga shfaqja e hemorragjisë gastrointestinale, meqenëse ulcera nuk ka bërë ende shërim të plotë. Trajtimi ushqimor i personave që vuajnë nga ulcera është i pamundur të kryhet në burgjet tona (*shih faqet 6-9 të vendimit nr. 298, datë 19.12.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër*).

21. Vendimi i gjykatës së apelit është kundërshtuar nga prokurori, i cili ka paraqitur rekurs bazuar në nenin 432 të KPP-së, duke kërkuar prishjen e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në rekursin e tij, prokurori ka pretenduar se: (i) vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe material të një rëndësie themelore për zhvillimin e praktikës gjyqësore, pasi në rastin konkret nuk ndodhemi përpara kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 260, pika 2, të KPP-së, në lidhje me të cilin kjo gjykatë nuk ka analizuar aspak kriteret e përcaktuara në të dhe, aq më shumë, për plotësimin e këtyre kriterëve në rastin konkret. Gjykata e apelit ka përdorur arsyetime jologjore dhe, për më tepër, në ndryshim nga sa rezulton nga aktet, ajo ka marrë përsipër të përcaktojë si të rëndë gjendjen shëndetësore të të arrestuarit; (ii) gjykata e apelit i është shmangur praktikës gjyqësore duke mos zbatuar drejt ligjin procedural penal, referuar vendimit unifikues nr. 7/2011, vendimit nr. 131/2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimit nr. 46/1999 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

22. Ndaj rekursit të prokurorit, kërkuesi ka paraqitur kundërrkurs, me të cilin ka kërkuar mospranimin e rekursit të prokurorit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Në kundërrkurs, kërkuesi ka pretenduar se: (i) vendimi gjykatës së apelit është në zbatim dhe interpretim të saktë, korrekt të dispozitave ligjore procedurale penale, si edhe në referim praktikës gjyqësore, konkretisht të vendimeve nr. 489/2000, nr. 8/2001 dhe nr. 122/2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndërsa në gjykim është provuar se gjendja e personit nën hetim është e përkeqësuar dhe duhet mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm, gjë që burgu nuk ia ofron kushtet e duhura, por mund të përkeqësojë dhe më shumë gjendjen e tij; (ii) në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe atyre të procedurës penale, gjykata ka marrë një masë sigurimi ekstreme atë të “Arresti në burg”, duke mos konsideruar në asnjë moment përshtatshmërinë e llojit të masës së sigurimit, pasi në gjendjen që janë aktet, edhe caktimi i një mase tjetër më të lehtë sigurimi mbi privimin e lirisë për veprën penale që dyshohet, do të ishte në raport të drejtë me shkallën e nevojave të sigurimit për rastin konkret; (iii) duke qenë se nevojat për caktimin e masës së sigurimit janë dinamike, kur vlerësohet se ka ndryshim të këtyre nevojave, masat e sigurimit mund të revokohen nga gjykata ose të zëvendësohen me një masë më të lehtë, apo më të rëndë, në përputhje me parashikimet e nenit 260 të KPP-së, ndërkohë që, në rastin konkret, gjykata e apelit ka çmuar për lehtësimin e pozitës së personit nën hetim përmes një mase më të lehtë se ajo e caktuar më parë, duke çmuar provat në përputhje me faktet e paraqitura nga palët.

23. Çështja është shqyrtuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, duke vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Sipas Kolegjit Penal, pretendimet e ngritura në rekursin e prokurorit lidhen me zbatimin e nenit 260 të KPP-së dhe ka për objekt vendimmarrjen e gjykatës së apelit. Duke qenë se nevojat për caktimin e masës së sigurimit janë dinamike, Kolegji ka mbajtur qëndrimin se kur vlerësohet që ka ndryshim të këtyre nevojave, për shkak të rrethanave ose fakteve të reja, të ndodhura pas momentit të caktimit të masës së sigurimit, të tillë që të ndikojë nevojat e sigurimit, masat e sigurimit mund të revokohen nga gjykata ose të zëvendësohen me masë më të lehtë ose më të rëndë, në përputhje me parashikimet e nenit 260 të KPP-së. Në rastin konkret, në përputhje me mjetin procedural të zgjedhur nga kërkuesi (zëvendësimi i masave të sigurimit), gjykata e shkallës së parë ka argumentuar se nuk evidentohet asnjë rrethanë ose fakt i ri i ndodhur pas momentit të caktimit të masës së sigurimit, i tillë që të ndikojë nevojat e sigurimit, duke i zbutur ato. Nga ana tjetër, në vendimmarrjen e gjykatës së apelit nuk rezulton të jetë arsyetuar lidhur me këtë fakt, pra nëse gjendja shëndetësore e personit nën hetim në momentin e paraqitjes së kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, pavarësisht datës së lëshimit të shkresave nga IEVP-ja, Lezhë, kishte pësuar ndryshime në krahasim me momentin e caktimit dhe miratimit të masës së sigurimit. Arsyetimi i gjykatës së apelit për pamundësinë e trajtimit ushqimor në burg të personave që vuajnë nga ulcera e stomakut nuk rezulton të jetë i bazuar mbi prova konkrete, pra mbi një pohim prej institucioneve të pamundësisë së mbajtjes dhe trajtimit të kërkuesit në kushtet e paraburgimit. Bazuar në këtë arsyetim, Kolegji Penal ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në rekurs e cenojnë vendimmarrjen e gjykatës së apelit, për rrjedhojë rekursi i paraqitur, referuar parashikimeve të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 432 të KPP-së e kalon pragun e pranueshmërisë për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit. Në lidhje me kundërrekursin, Kolegji Penal ka çmuar se shkaqet e paraqitura në të nuk janë të tilla që të çojnë në një vlerësim të ndryshëm. Për më tepër, një pjesë e shkaqeve të kundërrekursit i referohen vendimmarrjes së gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, e cila del jashtë këtij shqyrtimi gjyqësor që ka për objekt verifikimin e kushteve për zëvendësimin e kësaj mase sigurimi, për shkaqe të ndodhura pas caktimit/miratimit të masës përkatëse (*shih paragrafët 31-34 të vendimit nr. 00-2023-519 (98), datë 28.03.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

24. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në arsyetimin e vendimit të tij, është shprehur në thelb për zbatimin e nenit 260 të KPP-së, çka ishte edhe pretendimi kryesor i ngritur nga organi i akuzës, duke mos tejkaluar kompetencat e tij

dhe duke mos u shprehur tej shkaqeve të ngritura në rekurs. Prokurori në rekursin e tij, në thelb, ka pretenduar për zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal nga gjykata e apelit dhe shmangien prej saj nga praktika gjyqësore, duke e argumentuar këtë me mosekzistencën, në rastin konkret, të kushteve për zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, me mungesën e analizës nga gjykata e apelit të ekzistencës së këtyre kushteve, përveç se përdorimin nga ajo të arsytimeve joligjore për arritjen në përfundime faktike dhe shkencore që nuk gjenin mbështetje në aktet e administruara në gjykim. Është pikërisht ky pretendim dhe argumentet në mbështetje të tij, që janë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, duke vepruar kështu në përputhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes prej saj, pra brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs, sikurse përcakton neni 434, pika 1, i KPP-së. Në këtë rast, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar edhe pretendimet në kundërrkurs për sa ato lidheshin me objektin e shqyrtimit përpara saj. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj të interpretimit të ligjit procedural, ndërkohë që nuk rezulton se ky interpretim të jetë arbitrar.

25. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e procesit të rregullt ligjor, përfshirë edhe lirinë personale, të analizuar në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit ajo nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor, janë haptazi të pabazuara.

26. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuari nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.